



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



ANALISTËT KRITIKOJNË QËNDRIMET E FUNDIT TË KURTIT NDAJ SHBA-së

■ PAGE 4-5



Analistët politikë kanë reaguar ashpër ndaj qëndrimeve të fundit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ndaj ShBA-së, duke i cilësuar deklaratat e tij kontradiktore dhe të rrezikshme për interesat strategjike të

Kosovës. Njohësi i proceseve politike në vend, Ismet Kryeziu, ka thënë se akuzat e fundit të Kurtit ndaj ShBA-së, se gjoja veprimet e saj janë kundër sundimit të ligjit në veri dhe janë kërkesa për 'kusurijtë' me Serbinë e Rusinë në

kurritz të Kosovës, përbëjnë një theqafje politike për vendin. E Visar Ymeri ka theksuar se "nuk qenka problem (i Kurtit) ndikimi rus në Serbi, por ndikimi amerikan në Kosovë. A është duke e ditur Kurti se çfarë po flet?"

GUCATI U BËNË THIRRJE SHQIPTARËVE QË MË 17 TETOR TË BËHEN BASHKË NË TIRANË PËR ÇLIRIMTARËT F.3



HOTI PARALAJMËRON KRIZË SOCIALE DHE EKONOMIKE QË NUK ËSHTË PARË QË NGA 1999-ta F.3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



ALBIAN HAJDARI LË ZVICRËN PËR KOSOVËN, ADEMI I URON MIRËSEARDHJE F.10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MINISTRI GJERMAN: RUSIA PO BËHET GJITHNJË E MË KËRCËNUESE

BERLIN, 29 SHTATOR - Rusia po bëhet “kërcënim gjithnjë e më i madh” për NATO-n, tha të hënën ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Boris Pistorius. Pistorius e tha këtë gjatë një vizite në Poloni dhe Lituanë, në një kohë kur tensionet janë të larta në krahun lindor të aleancës ushtarake për shkak të shkeljeve ajrore nga dronët rusë. Duke folur në Forumin e Sigurisë në Varshavë, Pistorius tha se Moska po “teston aleatët e NATO-s me një shpeshtësi dhe intensitet në rritje”. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, po “përpiqet me qëllim ta minojë sigurinë evropiane dhe integritetin territorial të kombeve evropiane”, theksoi Pistorius. “Ai kërkon t’i provokojë

shtetet anëtare të NATO-s. Ai dëshiron t’i ekspozojë dobësitë brenda aleancës sonë”, nënvizoi ai. Por, NATO-ja ka “reaguar ndaj provokimeve të Rusisë me qartësi, unitet, vendosmëri dhe maturi”, shtoi ministri gjerman. “Ne nuk do të biem në kurthin e Putinit të përshkallëzimit të vazhdueshëm. Po ruajmë gjakftohtësinë duke qëndruar të palëkundur dhe të vendosur”, theksoi ai. Përkrah Pistoriusit, në forum ishin të pranishëm edhe ministri holandez i Mbrojtjes, Ruben Brekermans, dhe homologu i tij estonez, Hanno Pevkur, si dhe komisionari Evropian për Mbrojtje dhe Hapësirë, Andrius Kubilius.



Pistorius pritet, gjithashtu, të bisedojë për të ardhmen e marrëdhënieve të Ukrainës me Evropën në bisedime të nivelit të

lartë në kryeqytetin polak. Bisedimet vijnë disa javë pasi dronë rusë u rrëzuan mbi Poloni.

Incidenti u pasua nga shkelje të hapësirës ajrore të NATO-s në Rumani dhe Estoni. “Kur është e nevojshme, forcat e NATO-s janë të gatshme, ashtu si avionët e aleatëve tanë në Baltik që u ngritën dhe shoqëruan avionët rusë jashtë hapësirës ajrore të Estonisë”, tha Pistorius. Duke folur në këtë konferencë, kryeministri polak Donald Tusk tha se lufta e Rusisë në Ukrainë është pjesë e një projekti politik për nënshtrimin e popujve të tjerë. “Kjo luftë është edhe lufta jonë”, deklaroi Tusk. “Nëse e humbim këtë luftë, pasojat do të ndikojnë jo vetëm mbi gjeneratën tonë, por edhe mbi brezat e ardhshëm në Poloni, Evropë, Shtetet e Bashkuara dhe kudo tjetër në botë”, shtoi ai.

BE-JA KONFIRMON RIVENDOSJEN E SANKSIONEVE KUNDËR IRANIT



BRUKSEL, 29 SHTATOR - Bashkimi Evropian (BE) njoftoi të hënën se i ka rivendosur sanksione Iranit, duke e ndjekur hapin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). “Sot BE-ja riktheu sanksionet ndaj Iranit si përgjigje ndaj mosrespektimit të vazhdueshëm të marrëveshjes bërthamore. Dera për bisedime diplomatike mbetet e hapur”,

thuhet në një deklaratë të presidencës së BE-së. BE-ja bëri me dije se sanksionet përfshijnë ngrirjen e aseteve të Bankës Qendrore të Iranit dhe bankave të tjera iraniane, si dhe ndalimin e udhëtimit për disa zyrtarë iranianë. Gjithashtu, BE-ja ndaloi blerjen dhe transportin e naftës së papërpunuar nga Irani si dhe shitjen ose

furnizimin me ar dhe pajisje të caktuara detare. Të dielën Kombet e Bashkuara rikthyen një embargo armësh dhe sanksione të tjera ndaj Iranit për programin e tij bërthamor pas një procesi të nisur nga fuqitë evropiane, të cilit Teherani i është kundërpërgjigjur me paralajmërime për masa të ashpra.

Britania, Franca dhe Gjermania iniciuan rikthimin e sanksioneve ndaj Iranit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke e akuzuar Teheranin për shkeljen e marrëveshjes së vitit 2015, synimi i të cilës ishte të mos e lejonte Iranin të prodhojë ndonjë bombë bërthamore. Irani mohon se synon të prodhojë armë bërthamore.

I DËNUARI PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË LIROHET NGA BURGU

HAGË, 29 SHTATOR - Gjenerali serb Nebojsa Pavković, i dënuar për krime lufte kundër shqiptarëve në Kosovë, është liruar nga burgu në Finlandë dhe ka shkuar në Serbi, bëri me dije kryeministri serb Gjuro Macut më 28 shtator. Pavković, ish-komandant i Ushtrisë së Tretë të Jugosllavisë, me vendim të formës së prerë ishte dënuar me 22 vjet burgim për krime kundër shqiptarëve të Kosovës më 1999. Macut tha se është plotësuar kërkesa e Qeverisë së Serbisë që Pavkovićit, “për shkaqe shëndetësore, t’i mundësohet lirimi i parakohshëm”.

Ai shtoi se me këtë “akt konfirmohet se shteti kujdeset për qytetarët e vet dhe se angazhohet për parime humane në marrëdhëniet ndërkombëtare”. Sipas kryeministrit të Serbisë, Pavković do ta vazhdojë trajtimin mjekësor në Serbi. Lirimin e tij nga burgu e kishte paralajmëruar më herët presidenti serb Aleksandar Vučić. Pavković u shpall fajtor në vitin 2009 për të gjitha pikat e aktakuzës dhe u dënua për dëbime, zhvendosje të detyruara, vrasje dhe persekutim të civilëve shqiptarë nga Kosova në gjysmën

e parë të vitit 1999. Kundër tij dhe gjeneralëve të tjerë serbë, në fund të vitit 2003 u ngrit aktakuzë nga Tribunali i Hagës, ndërsa në vitin 2005 ai u dorëzua në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë në Hagë. Së bashku me të u dënuan edhe ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Jugosllavisë, Dragolub Ojdaniq, ish-komandanti i Korpusit të Prishtinës, Vladimir Llazareviq, gjenerali i policisë Sreten Llukiq dhe ish-nënkryetari i Qeverisë së Jugosllavisë, Nikolla Shainović. Pavković dhe Llukiq u dënuan



me nga 22 vjet burgim, ndërsa Ojdaniq dhe Llazareviq me nga 15 vjet. I pandehuri i parë, Slobodan Millosheviq, vdiq në paraburgim, ndërsa ish-presidenti i Serbisë, Millan Millutinović, u shpall i pafajshëm. Të gjithë të akuzuarit u dorëzuan

vullnetarisht. Mekanizmi në Hagë deri më tani nuk ka njoftuar për lirimin e Pankovićit. Në mesin e muajit gusht avokati Aleksandar Alleksiq dorëzoi një kërkesë urgjente për lirimin e parakohshëm të Pavkovićit, duke përmendur si arsye gjendjen shëndetësore. Mekanizmi Ndërkombëtar për Gjykatat Penale, në maj 2022, e kishte refuzuar kërkesën e Pavkovićit për lirimin e parakohshëm për shkak të “rëndësisë së madhe të krimeve të tij dhe mungesës së rehabilitimit”.

Vance thotë se ShBA-ja po shqyrton kërkesën e Ukrainës për raketat Tomahawk

UASHINGTON, 29 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara po e shqyrtojnë kërkesën e Ukrainës për të marrë raketa me rreze të gjatë veprimi, Tomahawk, për luftën e saj për ta zmbrapsur pushtuesin rus, tha të dielën

nënpresidenti amerikan JD Vance. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka kërkuar nga Shtetet e Bashkuara që t’u shesin raketa Tomahawk vendeve evropiane në mënyrë që ato pastaj t’ia

dërgojnë ato Ukrainës. Vance tha në “Fox News Sunday” se presidenti amerikan Donald Trump do ta marrë vendimin përfundimtar për këtë marrëveshje. “Ne po shqyrtojmë një numër kërkesash nga

evropianët”, tha Vance. Raketat Tomahawk kanë një rreze veprimi prej 2 500 kilometrash, që nënkupton se Moska do të ndodhej brenda rrezes së armëve të Ukrainës nëse Kievit do t’i jepeshin ato.



GUCATI U BËNË THIRRJE SHQIPTARËVE QË MË 17 TETOR TË BËHEN BASHKË NË TIRANË PËR ÇLIRIMTARËT

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryetari i Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, në një konferencë për medie të mbajtur në Tiranë, ka njoftuar se protesta e radhës në përkrahje të ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohej në Hagë do të mbahet pikërisht në kryeqytetin shqiptar, pas atyre të mbajtur në Prishtinë dhe Hagë.

Kjo protestë do të mbahet në sheshin “Skënderbej” më 17 tetor, me fillim nga ora 17:00, me moton “Drejtësi për çlirimtarët, kundër padrejtësisë në Hagë”. “Arsyeja tashmë është e qartë. Padrejtësia që po ushtrohet nga Gjykata Speciale kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne, bashkëluftëtarët dhe kategoritë e dala nga



lufta, shprehim mirënjohje të përhershme për shtetin shqiptar, për përkrahjen dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj kësaj çështje madhore

kombëtare. Mesazhi ynë është i qartë: Drejtësi për çlirimtarët, kundër padrejtësisë që po u bëhet atyre”, ka deklaruar Gucati në

këtë konferencë, duke u bërë thirrje shqiptarëve të bashkohen në këtë protestë. “Prandaj sot, nga kjo tryezë, u drejtohem të gjithë

shqiptarëve kudo që jetojnë e veprojnë, partive politike shqiptare, sidomos në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni: bashkohuni me ne në këtë protestë paqësore në Tiranë. Kjo nuk është çështje e disa individëve, por çështje dinjiteti, sakrifice dhe e së vërtetës sonë historike. Le të ngrihemi të gjithë si një zë i vetëm për të kërkuar drejtësi për çlirimtarët tanë dhe për t’iu kundërvënë padrejtësisë. Ju mirëpresim të gjithëve në Tiranë”, theksoi ai. “Ne jemi shqiptarë dhe na bashkon një gjuhë e një flamur. Ai flamur është flamuri i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Në sheshin ‘Skënderbej’, më 17 tetor nga ora 17:00, bashkohemi të gjithë të protestojmë kundër padrejtësisë që po bëhet në Hagë”, tha Gucati.

MALI I ZI I DËRGON NOTË VERBALE AMBASADËS SË KOSOVËS PËR TË SHTËNAT NË KUFİ

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi ka dërguar të hënën notë verbale Ambasadës së Kosovës në Podgoricë lidhur me të shtënat me armë zjarri që dyshohet se erdhën nga pjesa e Kosovës në zonën pranë qendrës malazeze të skijimit, Hajlla-Shtedim, afër kufirit mes dy shteteve. “Nga organet kompetente të Republikës së Kosovës është kërkuar që t’i identifikojnë dhe t’i procedojnë autorët e këtyre incidenteve, si dhe të njoftojnë Malin e Zi për të gjitha masat dhe veprimet e ndërmarra”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Malit të Zi për “Radion Evropa e Lirë” (REL).

Nga dikasteri i udhëhequr nga Ervin Ibrahimoviq vlerësojnë se bëhet fjalë për incidente të izoluara. Të paktën në dy raste janë regjistruar dëmtime në infrastrukturën e qendrës së skijimit Hajlla-Shtedim në Mal të Zi, e cila ndodhet rreth një

kilometër e gjysmë nga kufiri me Kosovën. Në të dyja rastet, organet kompetente malazeze dyshojnë se të shtënat janë shkrepur nga territori i Kosovës.

Incidenti i parë ndodhi në korrik të vitit të kaluar, kur u vërejtën dëmtime në kabinën e qendrës së skijimit. Prokuroria e Rozhajës ka hapur lëndë për këtë rast.

Ndërsa incidenti i dytë ndodhi më 24 gusht të këtij viti, kur pati të shtëna në drejtim të një objekti të qendrës së skijimit. Prokuroria pritet të hapë lëndë pas përfundimit të hetimeve të policisë.

Notë verbale është dërguar pas incidenteve të përsëritura që janë regjistruar nga Policia në Rozhajë, njoftoi Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi, e cila shton se për incidentet u njoftua më 22 shtator edhe ambasadorja e Kosovës. “Besojmë se rastet e izoluara nuk e reflektojnë përkushtimin e qartë të dy shteteve tona për forcimin e

bashkëpunimit rajonal dhe përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale”, thuhet në përgjigjen e Ministrisë për “REL”-in.

Po ashtu, theksohet se palës së Kosovës i është tërhequr veçanërisht vëmendja për rëndësinë e zbatimit të tri marrëveshjeve ndërmjet shtetesh - për kufirin shtetëror ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës, hapjen e pikës së përbashkët kufitare Kotlovi-Kuqishtë dhe rregullimin e regjimit të qarkullimit kufitar. Fadil Gashi nga Policia e Kosovës për rajonin e Pejës i tha “Radio Evropa e Lirë” se nuk ka asnjë informacion për incidente të sigurisë në kufirin me Malin e Zi, duke theksuar se policia rajonale është më shumë e angazhuar “për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike”, e jo për incidente ndërkombëtare.

“Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar edhe Drejtorisë Qendrore të Policisë së Kosovës me pyetjen nëse ka



ndonjë informacion lidhur me rastin dhe është në pritje të përgjigjes. Për të njëjtën çështje, përgjigje pritet edhe nga Qeveria e Kosovës.

Mali i Zi dhe Kosova në vitin

2015 e nënshkruan Marrëveshjen për Demarkacionin. Mali i Zi e ratifikoi atë në të njëjtin vit, ndërsa Kuvendi i Kosovës tri vjet më vonë.

KQZ-ja emëron mbi 15 000 anëtarë të këshillave të vendvotimeve

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë vendim për emërimin e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve të rregullta, atyre me kusht dhe anëtarëve rezervë për zgjedhjet lokale të cilët do të angazhohen në ditën e zgjedhjeve të 12 tetorit.

Sipas vendimit të KQZ-së, janë emëruar 14 305, anëtarë të 2 571 vendvotimeve të rregullta dhe 54 vendvotimeve me

kusht, ndërsa 1 200 anëtarë të tjerë do të jenë rezervë. “Sipas Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, Këshilli i Vendvotim është përgjegjës për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve. Procesi zgjedhor në Republikën e Kosovës, do të organizohet në 948 Qendra të Votimit me

gjithsej 2,625 vendvotime, prej të cilave 910 Qendra të Votimit për votimin e rregullt me 2 571 vendvotime dhe 38 Qendra të Votimit për votimin me kusht me gjithsej 54 vendvotime”, është thënë në njoftim.

Në pikën e fundit të rendit të ditës, KQZ-ja ka marrë vendim për miratimin e procedurës standarde të veprimit në lidhje me të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve të akredituar në Zgjedhjet Lokale 2025.





ANALISTËT KRITIKOJNË QËNDRIMET E FUNDIT TË KURTIT NDAJ SHBA-së

Analistët politikë kanë reaguar ashpër ndaj qëndrimeve të fundit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ndaj ShBA-së, duke i cilësuar deklaratat e tij kontradiktore dhe të rrezikshme për interesat strategjike të Kosovës. Njohësi i proceseve politike në vend, Ismet Kryeziu, ka thënë se akuzat e fundit të Kurtit ndaj ShBA-së, se gjoja veprimet e saj janë kundër sundimit të ligjit në veri dhe janë kërkesa për ‘kusuritje’ me Serbinë e Rusinë në kurriz të Kosovës, përbëjnë një theqafje politike për vendin. E Visar Ymeri ka theksuar se “nuk qenka problem (i Kurtit) ndikimi rus në Serbi, por ndikimi amerikan në Kosovë. A është duke e ditur Kurti se çfarë po flet?”

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, tha se arsyeja pse Uashingtoni ka pezulluar Dialogun e planifikuar Strategjik me Kosovën ka të bëjë me mbylljen e strukturave serbe në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. I pyetur gjatë një bashkëbisedimi

ta sqaronte arsyen e vendimit të kumtuar nga ShBA-ja më 12 shtator, Kurti tha se ai nuk mund të bëjë kompromise me sundimin e ligjit. “[Arsyeja e pezullimit të Dialogut të planifikuar Strategjik] është për shkak të sundimit të ligjit në veri të Kosovës, i cili rezultoi të ishte kundër strukturave ilegale serbe dhe këtu nuk mund të bëj kompromise. Nuk mund t’ia lë këtë problem brezit tuaj. Mendoj që brezi im është ai që duhet ta

përfundojë këtë”, tha Kurti. Kurti tha se raporti Kosovë - ShBA është tredimensional: mbrojtje, zhvillim dhe diplomaci. Përdorimi në dy shtyllat e para tha se nuk ka probleme, sa i përket diplomacisë, sipas tij, ka “pengesa”. “Kemi disa pengesa në diplomaci sepse, sipas meje, ShBA-ja e konsideron shumë të rëndësishme që ta tërheqë Serbinë nga hemisfera lindore, sepse Serbia është e lidhur ngushtë me Moskën dhe ne, duke qenë të palëkundur në sundimin e ligjit, demokracinë, sovranitetin shtetëror dhe integritetin territorial, disa politikanë dhe diplomatë në ShBA vlerësojnë se ne nuk po e ndihmojmë ShBA-në ta shkëpusë Serbinë nga Federata Ruse. Por, sinjerisht, ky nuk duhet të jetë problemi im”, tha Kurti, duke shtuar se ai përfaqëson interesat e Kosovës. Më 12 shtator Ambasada e Amerikës e arsyetoi vendimin për pezullimin e dialogut me veprimet e qeverisë në detyrë dhe me rritjen e tensioneve dhe paqëndrueshmërisë në vend.

Përmes një njoftimi, Ambasada e Amerikës në Kosovë tha se veprimet e qeverisë së udhëhequr nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, kanë “ritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë, duke kufizuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të punuar në mënyrë produktive me Kosovën mbi prioritetet e përbashkëta”. “Fatkeqësisht, veprimet dhe deklaratat e fundit të kryeministrit në detyrë Kurti kanë paraqitur sfida për progresin e arritur ndër vite”, tha ajo, pa shpjeguar se për çfarë deklaratash dhe veprimesh bëhet fjalë saktësisht. Kurti në ShBA tha se ai nuk është kryeministër që i thotë Policisë së Kosovës të mos e arrestojë një kriminel serb të kapur në flagrancë, “sepse ky veprim mund të dënohet nga Brukseli dhe Uashingtoni”. “Dhe unë u dukem atyre shumë ndryshe nga paraardhësit e mi. Ky është mallkim nga paraardhësit e mi, të cilët kanë qenë të butë. Unë jam normal, por dukem ekstrem. Kjo është për shkak të paraardhësve të

mi të cilët nuk kanë qenë normalë”, u shpreh Kurti. Kurti tha se në mes të Kosovës dhe ShBA-së ka dallime kur bëhet fjalë “në taktika dhe veprime” e jo në vlera, interesa dhe parime.

Ymeri kritikon qëndrimet e Kurtit: Ndikimi rus në Serbi nuk qenka problem, por ai amerikan në Kosovë po?

Analisti politik Visar Ymeri ka reaguar ashpër ndaj qëndrimeve të fundit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, duke i cilësuar ato kontradiktore dhe të rrezikshme për interesat strategjike të Kosovës. Në rrjetet sociale, Ymeri ka vënë në pikëpyetje deklaratat e Kurtit që, sipas tij, nuk e konsideron lidhjen e ngushtë të Serbisë me Rusinë si problem për Kosovën dhe rajonin, ndërkohë që ka shprehur mospajtime me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për zhvillimet në veri të vendit. “Si nuk qenka problem yni edhe

DHUNUESIT E KUSHTETUTËS



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Të hurit e të konopit, injorantë: Gjykata Kushtetuese në një vend normal është Mali Olimp i interpretimit të Kushtetutës së vendit, mbi të është vetëm Gjykata për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës falë mashtruesve Kurthi, Osmani, Shvarc dhe Konjufca që u përpoqën t'i mashtrojnë baballarët e mashtrimit - ndërkombëtarët. Kurthi dhe Zonja Vdekje e "diplomacisë" kosovare, brenda natës ua bartën pronat popave të Manastirit të Deçanit duke dhunuar rregullat e kadastrës gjithnjë duke u thirrur në një vendim të Gjykatës Kushtetuese. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për popat e Manastirit nuk i bë në fillim të mandatit qeverisës por në fund. Po të ishte bërë në fillim të mandatit sot Kosova do të ishte në Këshill të Evropës. Patriotizmi folklorik i mashtruesve, edhe i pajisi me fletë poseduese popat e Manastirit të Deçanit për toka që ua kishte dhuruar Sllobodan Millosheviqi, edhe na la jashtë Këshillit të Evropës. Fillimisht nuk e pranuan vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pastaj për një bythë pushteti brenda 24 orëve e zbatuan këtë vendim. Kur Gjykata Kushtetuese e rrëzoi

qeverinë e KM Avdullah Hoti, këta musketarët e patriotizmit folklorik, antikombëtarë dhe mjeranë mashtrues e lëvduan këtë Gjykatë deri në qiell. Çdo vendim i GJK që ishte në dobi të pushtetit, përkrahej dhe glorifikohej, deri në orgazëm. Në të kundërtën, çdo vendim që ua shkelte kallon e pushtetit sulmohej nga, kryesisht militantë injorantë që nuk kanë as njohuri elementare për Kushtetutën. Paraprakisht, fitilin e këtyre sulmeve e ndezte, Albin Kurthi e që pastaj, në vallen e injorancës mindilin e merrte Lenka Haxhiu, Arbëresha, Sali Protopapa, Lil Kumbara i spasiqëve, Lal Culla, Elbert Krasniqi, Donika Shvarc, Pec Krymbi etj. Për ta përfunduar vallen e injorancës, mindilin (nga xhepi i doktor hajnit) e merrte një super mashtruese dhe super përfituese, Vojsa Osmani. Me rëndësi jetike është se Lenka Haxhiu dhe Vojsa Osmani janë juriste që edhe më shumë e komprometojnë besimin në shtetin ligjor dhe shtetin e së drejtës.

Pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 kur lëkundej pushteti, Kurthi me zonjën Mihalidis u përcaktuan për bllokim të formimit të institucioneve duke e ngritur lart flamurin e patriotizmit të remë -

luftën kundër Listës Serbe. Lufta bëhej përmes marionetave në KQZ dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Paralelisht donin ta shpallnin Listën Serbe si organizatë terroriste, jo me vendim të gjykatës por me vendim politik duke u mbuluar me Millan Radoiçiqin kurse, në anën tjetër shefja e GP-së të LVV-së, mercenare e të gjitha pushteteve, Mimoza Kusari shkrihej duke u llafosur me Sllavko Simiqin dhe Millan Radoiçiqin, si biseda midis zemlakut dhe zemlakes. Pas çdo vendimi ua bënë publik emrat e gjykatësve të GJK që nuk "ua krehnin bishtin.", duke ua bërë pushkatimin publik. Një gjykatësi të Gjykatës Supreme ia ndryshuan emrin dhe përkatësinë etnike, nga Leku e bënë Elek. Rrogëtarja permanente e Kurthit, Vojsa Osmani, për ta rifituar besimin e gospodarit, thirri mbledhje të jashtëzakonshme për media. Mendova se po i shpallë luftë Serbisë, jo shkaku i Kosovës por shkaku i Ukrainës. Kur, kjo super mashtruese dhe super përfituese tha se rreziku kryesor për Kosovën është Llabani, prandaj të gjithë duhet t'i bashkëngjiten këtij inkursioni të sajuar, jo për të mbrojtur rendin kushtetues por për të siguruar edhe një mandat. Brutaliteti i sulmeve ndaj Gjykatës

Kushtetuese ka qenë i pashembullt për një vend normal dhe politikanë normal! Qëllimi ka qenë që vendi të zhytet në një krizë për ta instaluar dhe legalizuar anarkinë e menaxhuar mirë për ta mbajtur pushtetin. Kjo nuk ka lidhje as me "luftën" kundër Listës Serbe e as me Llabanin, është vetëm pretext për një çmenduri të orkestruar të grabitësve të pushtetit, antikombëtarë, anti-shtet dhe anti-UÇK. Sikur që çdo gjë e ka një fund, edhe këto sulme do ta kenë një sulm, të imponuar nga frika, gjithsesi. Nga frika nga ndërkombëtarët. Pas pezullimit të Dialogut Strategjik, bisedës nga DASH-i me kryetarin e GJK dhe vizitës së shefit të EULESH-it gjyqtarit Leku, shqiponjat e LVV-së u bënë pula të ndukura. Siç thotë Kurthi; brenda shqiponja me ndërkombëtarët pula (për regjimin e "vjetër"..), edhe regjimi aktual është i njëjtë, edhe më të mjerë madje. Nga frika se mund të sanksionohen edhe më shumë janë shndërruar në pula. Në fakt i janë kthyer origjinës, asnjëherë nuk kanë qenë shqiponja! Janë palosur përkohësisht. Kurthi në vizitat e kurdisura në Amerikë ia dha një rrebesh GJK të Kosovës para një grushti komunistësh amerikanë.

Cili do të jetë vendimi i GJK-së: Nuk jam njohës i GJK të Kosovës si Kadriu p.sh. por mendoj se mund të jetë vetëm një vendim normal dhe kushtetues; rikthimi në pako i votimit për nënkryetarët e pakicave. LVV-ja është para një sfide, po nuk e votuan Simiqin, nuk votohet as Emily Bronte Redzeqi. Një propozim miqësor edhe për LVV-në, edhe për opozitën; votoni kandidatët e propozuar nga pakicat, as nuk bëni tradhti e as nuk bëheni më patriotë! Kështu keni votuar në vitin 2021, dhe, asgjë nuk humbët! Votoni dhe merrni vesh për një koalicion qeverisës, nuk ka tjetër rrugëdalje. Qoftë edhe deri në zgjedhje të reja!

Gara për Prishtinën: Janë tre kandidatë vetëm për një post të kryetarit: Përparim Rama, Hajnrullah Çeko dhe Uran Ismaili. Rama qeverisjen e ka rutinë, Çeko nuk ka personalitet, por e ka partinë e fortë. Uran Ismaili ka personalitet, por ngecën me parti. Përkundër simpative apo dëshirës, jam fort i sigurt se Përparim Rama do të fitojë edhe një mandat nëse në ndërkohë nuk ndodh ndonjë shembje e madhe. Do të jenë interesante koalicionet pas balotazhit, do të ketë koalicione të pabesueshme!

largimi i Serbisë nga Rusia? A nuk është ndikimi rus në Evropë dhe rajon rrezikim i përgjithshëm i sigurisë, demokracisë e progresit? Një Serbi e lidhur ngushtë me Rusinë është një Serbi e fuqizuar ushtarakisht, autoritare përsërbrendshmi dhe e rrezikshme për secilin në rajon. Madje edhe e nxitur për tensionim të vazhdueshëm në Bosnje e Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni të Veriut. Për Albin Kurtin këto nuk qenkan problem i tij. Si bëhet që siguria e Kosovës nuk qenka problem i Albin Kurtit? Në anën tjetër u paska thënë studentëve që

ShBA kundërshton vendosjen e rendit dhe të ligjit në veri dhe për këtë kemi mospajtime (të cilat realisht janë sanksione nga ShBA ndaj Kurtit). Problemi i dytë ky: Kurti po thotë që ShBA e përkrahin krimin në veri meqë e sanksionojnë Kosovën kur e lufton atë. Sëkëndejmi nuk qenka problem (i Kurtit) ndikimi rus në Serbi, por ndikimi amerikan në Kosovë. A është duke e ditur Kurti se çka po flet? Apo thjeshtë është freestyling (çka t'i bien në mend qaty për qaty). Po shpresoj që përnjëmend nuk po e din. Po shpresoj që këto qëndrime janë të rastësishme", ka shkruar Visari.

Kryeziu për deklaratat e Kurtit ndaj ShBA-së: Goditje ndaj sovranitetit dhe cenim i aleancës strategjike

Edhe drejtori i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka reaguar pas deklaratave të fundit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, i cili, sipas Kryeziut, ka akuzuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës se po vepron kundër sundimit të ligjit në veri të Kosovës dhe po kërkon "kusuritje" politike me Serbinë dhe Rusinë në kurriz të Kosovës. Kryeziu ka theksuar se këto deklaratat nuk i shërbejnë as forcimit të shtetit, as interesit

kombëtar, porse janë vetëm kalkulimeve të ngushta të një lideri që konfrontimin brenda dhe jashtë vendit, e sheh si mundësi elektorale. "Akuzat e fundit të Albin Kurtit ndaj ShBA-së, se gjoja veprimet e tyre janë kundër sundimit të ligjit në veri dhe janë kërkesa për 'kusuritje' me Serbinë e Rusinë në kurriz të Kosovës, përbëjnë një theqafje politike për vendin. Kjo gjuhë nuk i shërben as forcimit të shtetit, as interesit kombëtar, por vetëm kalkulimeve të ngushta të brendshme të një lideri që konfrontimin brenda e jashtë e sheh si mundësi elektorale. Për

më shumë se 25 vjet, ShBA ka qenë garancia kryesore e sundimit të ligjit në veri, mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës. Sot, një ish-kryeministër dhe kandidat për kryeministër del me akuza të tilla, duke pretenduar se pikërisht ShBA është kundër këtyre parimeve. Ky është një cenim i drejtpërdrejtë i aleancës strategjike më të fuqishme të Kosovës, në thelb, një goditje ndaj vetë integritetit dhe sovranitetit të vendit nga një udhëheqës shteti", ka shkruar Kryeziu në "Facebook".

Fillon vaksinimi kundër gripit sezonal

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prishtinë ka njoftuar se të mërkurën do të fillojë vaksinimi kundër gripit sezonal. Lajmin e ka dhënë QKMF-ja përmes një njoftimi në rrjetin social “Facebook”. “Ju njoftojmë se nga data 01.10.2025 fillon vaksinimi kundër gripit sezonal. Ju mund ta merrni këtë shërbim në QMF-të më të afërta që i keni ku ka njësi të vaksinimit”, bëhet me dije në njoftimin për medie. Në njoftim thuhet se qytetarët për t’u vaksinuar duhet ta kenë letërnjoftimin ose certifikatën e lindjes edhe për fëmijët e vegjël për shkak të regjistrimit të të dhënave në sistem.



POLICIA, LIGJËRATA NDËRGJEGJËSUESE PËR PARANDALIMIN E DUKURIVE NEGATIVE DHE PËRDORIMIT TË DROGAVE

GJILAN, 29 SHTATOR - Njësia e Komunitetit e Stacionit Policor në Gjilan ka mbajtur të hënën një ligjëratë ndërgjegjëse me temën “Parandalimi i dukurive negative dhe drogave”, në ambientet e Shkollës Fillore “Thimi Mitko” në qytetin e Gjilanit. Ligjërata është mbajtur me nxënësit e klasave VII dhe VIII, me fokus të veçantë në ngritjen e vetëdijes për pasojat që sjellin dukuritë negative dhe përdorimi i substancave narkotike në jetën dhe mirëqenien e të rinjve. Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit u theksua roli i rëndësishëm që luajnë mësimmshënësist, stafi mbështetës dhe vetë nxënësit në identifikimin, parandalimin dhe raportimin e rasteve të tilla. Ky aktivitet është pjesë e një sërë iniciativash që Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjilan, përmes njësive të saj, zhvillon në bashkëpunim të ngushtë me institucionet arsimore, me qëllim të krijimit të një ambienti të sigurt shkollor dhe mbështetës për të gjithë nxënësit.



PROKURORIA SPECIALE DHE POLICIA KRYEJNË KONTROLL NË KRU “GJAKOVA” DHE NË SHTËPINË E KRYESHEFIT

GJAKOVË, 29 SHTATOR - Prokuroria Speciale e Kosovës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, bazuar në urdhrin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka realizuar të hënën një urdhër kontrolli në objektin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Gjakova” dhe në shtëpinë e të dyshuarit, kryeshefit ekzekutiv të kësaj kompanie. Policia e Kosovës ka njoftuar se hetuesit policorë nga Drejtoria e Krimeve Ekonomike kanë kryer urdhër kontrollin në kuadër të hetimeve që në koordinim me Prokurorinë Speciale janë duke u ndërmarrë për të gjitha dyshimet që janë objekt i hetimit penal. “Gjatë operacionit policor janë sekuesturuar prova materiale (dokumente) të cilat do të shërbejnë si prova relevante për rastin. Hetimet po zhvillohen për shkak të dyshimeve për kryerjen e veprave penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar; Falsifikimi i dokumentit zyrtar; Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore; Konflikt i interesit dhe Keqpërdorimi dhe Mashtrimi në prokurorim publik. Prokuroria Speciale në bashkëpunim me Policinë e Kosovës është duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale”, ka njoftuar Policia e Kosovës.



BE MONITORON ZGJEDHJET LOKALE NË KOSOVË, REXHEPI GARANTON BESUESHMËRI INSTITUCIONALE

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi, ka prituri të hënën në takim ekipin nga Misioni i Ekspertëve të Zgjedhjeve të BE-së (EEM), në përbërje të udhëheqësit të ekipit Konrad Olszewski dhe ekspertës ligjore Eirini Skouzou, me të cilët ka diskutuar për procesin e zgjedhjeve lokale në Kosovë të cilat do të mbahen më 12 tetor. Rexhepi i njoftoi ekspertët lidhur me trajtimin e ankesave administrative të paraqitura në Gjykatë Supreme kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), duke theksuar se zhvillimi i proceseve zgjedhore në vend ka arritur nivel të konsiderueshëm konsolidimi dhe besueshmërie institucionale. Në anën tjetër, ekspertët e EEM-së nënvizuan se pas përmbylljes së procesit zgjedhor do ta hartojnë dhe publikojnë Raportin Final, i cili do të përmbajë rekomandime për avancimin e mëtejshëm të standardeve zgjedhore në Kosovë.



Kurti dhe Lawler diskutojnë për thellimin e partneritetit në mes të Kosovës dhe ShBA-së

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka takuar kongresistin amerikan nga radhët e Partisë Republikane, Mike Lawler, njëherësh anëtar i Komitetit për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se diskutuan për mënyrat se si të thellohet partneriteti ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me theks të veçantë te bashkëpunimi ekonomik, investimet e huaja direkte dhe shkëmbimet tregtare, si dhe për rolin e rëndësishëm të diasporës sonë në këtë drejtim. Kryeministri Kurti e njoftoi kongresistin për zhvillimet e fundit në vend dhe përparimin e arritur vitet e fundit në ekonomi, demokraci, siguri dhe sundimin e ligjit. Gjithashtu, diskutuan edhe për rreziqet dhe sfidat e ndikimit rus në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor. Kongresmeni Lawler në këtë takim e informoi kryeministrin Kurti për vendimin e tij për t’iu bashkuar Kaukusit të Çështjeve Shqiptare në Kongresin Amerikan.




Bankat e shkollave në Kosovë po zbrazen: 28 mijë nxënës më pak për katër vjet

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Arsimi parauniversitar në Kosovë, që përfshin shkollat fillore dhe të mesme, po përballet me një rënie të theksuar si në numrin e nxënësve, po ashtu edhe në numrin e stafit arsimor. Të dhënat e Institutit GAP tregojnë se në katër vitet e fundit (2021/22-2024/25), janë 28 670, ose 9 %, nxënës më pak, ndërsa sistemi ka humbur gjithsej 717 punonjës arsimorë. Në vitin 2021/22 në shkollat e Kosovës ishin regjistruar mbi 309 mijë nxënës, ndërsa këtë vit numri ka zbritur në 280 876. Rënia është e përgjithshme

pothuajse në të gjitha komunat, me përjashtim të Fushë-Kosovës, që ka shënuar rritje prej 10 %, dhe Junikut me 6 %. Në anën tjetër, komunat me rënie më të lartë të nxënësve janë Klokoti dhe Zveçani, secila me nga 27 %. Krahas zvogëlimit të popullsisë shkollore, edhe numri i mësuesve ka pësuar ulje. Në nivel vendi janë 413 mësues më pak, duke përfaqësuar një rënie prej 2 %. Rënia është më e theksuar në Kaçanik dhe në Mitrovicë. Ndërsa Fushë-Kosova shfaqet sërish si përjashtim me rritje prej 23 % në numrin e mësuesve. Në këtë komunë raporti nxënës-

mësues është më i larti në vend. 19 nxënës për një mësues, kurse në nivel kombëtar ky raport qëndron në 12 nxënës për një mësues. Stafi administrativ dhe ai mbështetës kanë ndjekur të njëjtën prirje. Në total janë 167 më pak punonjës administrativë dhe 137 më pak punonjës mbështetës në krahasim me katër vjet më parë. Ndërsa disa komuna kanë parë shtime të vogla, shumica kanë shënuar ulje, me Junikun që regjistron rënie më të lartë në stafin mbështetës (-60 %) dhe Mitrovicën në atë administrativ (-32 %).



HOTI PARALAJMËRON KRIZË SOCIALE DHE EKONOMIKE QË NUK ËSHTË PARË QË NGA 1999-ta

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ish-kryeministri dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar se Kosova do të përballet me një krizë sociale dhe ekonomike për shkak të mungesës së një qeverie të re e cila nuk është formuar ende, edhe pas tetë muajsh nga mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme. “Kosova nuk ka qeveri të re as pas tetë muajsh nga mbajtja e zgjedhjeve të përgjithshme. Nuk është hapur rruga as për zgjedhje të reja, pasi partia që ka dalë e para në zgjedhje, në vazhdimësi e shkel Kushtetutën gjatë procedurave të konstituimit të Kuvendit. Si rezultat, Gjykata Kushtetuese detyrohet të caktojë disa herë masë të përkohshme. Në anën tjetër, dikasteret qeveritare janë pothuajse jofunksionale, pasi gjysma e anëtarëve të Qeverisë në detyrë e dinë se po qëndrojnë në zyrë në mënyrë joligjore, siç është konstatuar nga Gjykata Supreme në rastin e Ministrit të Financave. Si rezultat, mungon vendimmarrja dhe angazhimi i plotë i dikastereve qeveritare. Të gjithë ata e dinë se do të përballet me ligjin kurdoherë”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Ai ka thënë se buxheti i vitit 2026 nuk mund të miratohet në mungesë të Kuvendit funksional. “Sipas evidencës që kam,



Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028 nuk është miratuar në Qeveri. Ky dokument është bazë për nxjerrjen e Qarkores Buxhetore 2026/01, në bazë të së cilës përgatiten buxhetet e organizatave buxhetore. Pa buxhet të miratuar për vitin 2026, nga janari i vitit 2026 asnjë cent nuk mund të paguhet për paga e pensione, asistencë

sociale apo mallra dhe shërbime për nevoja elementare të institucioneve. Kjo do të prodhojë krizë sociale dhe ekonomike që nuk është parë asnjëherë nga viti 1999. Kjo është papërgjegjësi e madhe e lidhshme politike dhe institucionale”, është shprehur Hoti. Ai ka shtuar se ekonomia është në konfuzion për shkak të pasigurisë

institucionale. “Prodhimi vendor duket se ka rënë, pasi deficit i tregtar po thellohet me ritme të shpejta. Sivjet, importi i mallrave do të arrijë nivele rekorde, duke iu afruar shifrës 7 miliardë euro. Eksportet, edhe ashtu në shifra të vogla, janë në rënie krahasuar me vitin paraprak. Mbulueshmëria e importeve me eksporte ka rënë nga 16.1% sa ishte në vitin 2021, në 14.8% në vitin 2024, me

tendencë rënieje të mëtejme. Në muajin gusht 2028, mbulueshmëria e importeve me eksporte ishte vetëm 12.4%. Bizneset po përballet me mungesë të punëtorëve, përfshirë edhe ata me arsim fillor, që reflekton emigrimin në rritje të fuqisë punëtore. Rritja e pagave nga bizneset private nuk po e zgjidh problemin. Emigrimi duket se është proces shumë më kompleks për t’u shpjeguar vetëm me mundësitë për punë dhe pagë më të lartë në vende të tjera, që nënkupton se problemet bazike shoqërore janë përcaktues kryesorë të vendimit për emigrim”, ka deklaruar deputeti i LDK-së. Sipas Hotit, në anën tjetër, krerët e shtetit enden nëpër takime në ShBA, shumica e tyre pa asnjë rëndësi shtetërore. “Ligjërimet e tyre nëpër ngjarje të ndryshme janë jo-shtetërore, ato nuk paraqesin gjendjen reale në asnjë aspekt. Ata po harrojnë se Kosovën e kanë njohur shumica e shteteve të botës, se Kosova ka nënshkruar MSA-në, se ka hyrë në bashkëpunime bilaterale e multilaterale në shumë drejtime dhe fusha. Tani Kosova ka përgjegjësi politike, ekonomike e të sigurisë për vete dhe për aleatët. Kosova pritet të luajë rol në sigurinë e përgjithshme, të jetë konstruktive dhe gjithmonë në bashkërenditje me strategjinë dhe veprimet e aleatëve perëndimorë”, ka thënë Hoti.

Maqedonci po merr pjesë në Forumin e Sigurisë në Varshavë

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, me ftesë të Forumit të Sigurisë së Varshavës, po merr pjesë në punimet e forumit, një prej ngjarjeve më të rëndësishme ndërkombëtare të sigurisë në Evropë. Në kuadër të këtij forumi ministri Maqedonci do të jetë folës në panelin me titull “Të lidhur, por të mbrojtur: shtylla

digjitale e demokracisë modern”. Sesioni i këtij viti është fokusuar në veçanti në sfidat e shumëfishta dhe komplekse të sigurisë me të cilat po përballet kontinenti ynë, duke filluar nga kërcënimet konvencionale të sulmet kibernetike, disinformimi dhe lufta hibride. Në margjinat e kësaj konference, përveç pjesëmarrjes në sesionet

punuese, ministri Maqedonci do të realizojë edhe takime bilaterale me homologë si dhe përfaqësues të tjerë politikë dhe ushtarakë të vendeve partnere. Thellimi i bashkëpunimit ndërmjet aleatëve dhe partnerëve që përfaqësojnë vlerat e njëjta demokratike është thelbësor për frenimin e kërcënimeve që vijnë nga regjimet autokratike.



PSE PO RRITE KAMATAT PËR KREDI?

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Normat e interesit në bankat komerciale në Kosovë kanë shënuar rritje të ndjeshme nga muaji i kaluar, duke rënduar buxhetet familjare dhe planet investuese të bizneseve. Gazetarët e “Radios Evropa e Lirë”, duke u paraqitur si klientë të interesuar, testuan tregun bankar në fund të gushtit. Dallimi ishte i dukshëm: disa banka ofruan kredi me norma interesi mbi 7 %, njëra 8 % - nga rreth 6 % sa ishin më parë, ndërsa për bizneset normat ngjiteshin mbi 10 %.

Punonjësit bankarë dhanë përgjigje të ngjashme: “Kamatat janë rritur shumë”, por askush nuk dha një shpjegim të qartë pse.

Në pyetjet drejtuar disa bankave për këtë çështje - përfshirë Raiffeisen, BKT, ProCredit, NLB, TEB dhe BPB, “Radio Evropa e Lirë” nuk mori përgjigje.

Por, rritjen e konfirmon Banka Qendrore e Kosovës (BQK), edhe pse me shifra më të ulëta nga sa e paraqesin bankat. Sipas të dhënave të BQK-së dërguar “REL”-it, norma mesatare e interesit në kredi në korrik të vitit 2025 ishte 6.38 %, nga 6.17 % një vit më parë. Sipas punonjësve bankarë, rritja faktike nisi nga gushti e kënde.

Faktorët që ndikuan në rritjen e kamatave

Ekspertët financiarë thonë se rritja e normave të interesit lidhet kryesisht me tre faktorë: politikat e Bankës Qendrore të Kosovës,



inflacionin dhe krizën institucionale. Ish-gubernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, shpjegon se një ndikim të madh ka pasur rritja e rezervave të detyrueshme që bankat duhet t’i mbajnë. Derisa më parë bankat mbanin kapital prej 8 % deri në 12 % të aseteve të rrezikuara, nga qershori i këtij viti BQK-ja e ka rritur këtë normë në 10 % deri në 14 %. Kjo do të thotë se për çdo kredi të dhënë, bankat duhet të mbajnë më shumë kapital rezervë. Dhe, për ta kompensuar këtë “bllokim kapitali”, bankat shpesh rrisin normat e interesit ndaj klientëve, thotë Mehmeti. “Për shembull, nëse një bankë jep kredi prej 100 milionë eurosh, më parë duhej të mbante tetë milionë euro kapital, ndërsa tani janë dhjetë milionë - dy milionë euro më shumë të bllokuara që nuk mund të përdoren për kredi të reja”, shpjegon Mehmeti,

themelues i Institutit Hulumtues për Ekonomi dhe Financa, për “Radion Evropa e Lirë”. Kjo çështje ishte e rregulluar me Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, të vitit 2015, që përcaktonte mbajtjen e kapitalit nga 8 % deri në 12 % të totalit të aseteve të rrezikuara. Por, BQK-ja konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se ka vendosur një shtesë prej 2 % mbi asetet me rrezik. Ky vendim u mor vitin e kaluar, por zbatimi i tij nisi në qershor dhe synon “ta forcojë qëndrueshmërinë e sektorit financiar në Kosovë”. Mehmeti thotë se një tjetër arsye për rritjen e normave të interesit është edhe rritja e inflacionit. Në gusht të këtij viti, inflacioni arriti në 4.5 %, krahasuar me 1.4 % në gusht të vitit të kaluar. “Kur çmimet rriten, paraja humb vlerë”, thotë Mehmeti dhe, për t’u mbrojtur nga kjo humbje, bankat

rrisin normat e interesit. “Inflacioni i lartë rrit rrezikun që qytetarët të mos përballojnë pagesat e kredive, pasi shpenzimet e përditshme janë më të larta. Kjo i shtyn bankat të kërkojnë një parim më të madh për rrezikun, duke çuar në kamata më të larta”, shton Mehmeti. Përveç faktorëve ekonomikë, profesori i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi, thotë se në rritjen e normave të interesit ka ndikuar edhe kriza politike. Kosova tash e sa muaj është me qeveri në detyrë dhe pa Kuvend të konstituuar plotësisht. Bektashi thotë se mosmarrja e donacioneve apo kredive ndërkombëtare, që kërkojnë miratim me dy të tretat e votave në Kuvend, ka zvogëluar qarkullimin e euros në treg. “Mungesa e parasë ul ofertën dhe rrit kërkesën për kredi, duke shtyrë bankat t’i rrisin kamatat”,

shpjegon Bektashi për “Radion Evropa e Lirë”. Për shkak të bllokadës institucionale, tetë marrëveshje ndërkombëtare për financime dhe kredi me Bashkimin Evropian, të publikuara vitin e kaluar në faqen zyrtare të Kuvendit, nuk janë miratuar ende.

Si për Mehmetin, ashtu edhe për Bektashin, situata është interesante për tregun bankar, pasi normat e interesit për kredi po rriten, ndërsa ato për depozita më ngadalë.

Bektashi thotë se ulja e normave të interesit për kredi mund të arrihet përmes rritjes së konkurrencës. “Të licencohen banka të reja që të hyjnë në tregun e vendit, në mënyrë që t’i detyrojnë bankat ekzistuese t’i ulin normat e interesit”, thotë Bektashi, duke shtuar se fitimet e bankave, aktualisht, janë të larta. Bankat komerciale në Kosovë i përcaktojnë individualisht normat e interesit dhe të depozitave, duke u bazuar në politikat e tyre afariste, dhe BQK-ja nuk ka të drejtë të ndërhyjë direkt te to. Sipas BQK-së, tregu bankar funksionon si një treg i lirë, ku kushtet e tregut përcaktojnë koston e fondeve dhe të kredive.

Në Kosovë operojnë 11 banka komerciale, ndërsa funksionojnë edhe nëntë institucione mikrofinanciare që ofrojnë kredi për qytetarët. Megjithëse kushtet e këtyre të fundit janë më të lehta, normat e interesit që aplikojnë janë dukshëm më të larta, rreth 20 për qind.

DEFICITI MË I MADH TREGTAR NË HISTORI, AKB: MODELI EKONOMIK I QEVERISË PO E SHKATËRRON VENDIN

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësimin e thellë për përkeqësimin e bilancit tregtar të Kosovës dhe varësinë e rrezikshme nga importet. Vetëm një muaj më parë kryetari i AKB-së, Agim Shahini, kishte paralajmëruar se importet për vitin 2025 do ta arrinin shifrën rekord prej 7 miliardë eurosh. “Shifrat e 9 muajit të parë tashmë e vërtetojnë këtë trend: importet kanë kaluar 5 miliardë euro, ndërsa eksportet janë ulur me rreth 30 milionë euro krahasuar me vitin e kaluar. “Kjo është pasqyra më e qartë e një ekonomie të brishtë, që konsumon produkte të gatshme nga jashtë dhe eksporton para të gatshme. Kosova po varfërohet çdo ditë, qytetarët po humbasin fuqinë blerëse, dhe prodhuesit vendorë po mbesin pa përkrahje. Nëse qeveria vazhdon të heshtë, ky vit do ta gjejë Kosovën me deficit tregtar më të thelluar në histori”, tha kryetari i AKB-së, Agim Shahini. Kryetari i AKB-së thekson se mungesa e politikave



zhvillimore ka bërë që ekonomia e Kosovës të mbështetet kryesisht në ndërtimtari dhe tregti, ndërsa sektorë strategjikë si bujqësia, prodhimi, industria nxjerrëse dhe energjia po mbeten nën potencial. Ai ka deklaruar se ky model jo vetëm që nuk krijon zhvillim afatgjatë, por po e dëmton rëndë stabilitetin ekonomik të vendit. “AKB-ja i bën thirrje Qeverisë së Kosovës të marrë përgjegjësi dhe të veprojë me masa konkrete: subvencionim real dhe përkrahje për prodhuesit vendorë, lehtësira për eksportuesit dhe hapje të tregjeve të reja, orientim i investimeve në prodhim, bujqësi, industri dhe energji, politika fiskale që forcojnë fuqinë blerëse të qytetarëve, hartim të një strategjie kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kosova nuk mund të ndërtojë mirëqenie mbi konsum dhe import. Pa prodhim, eksport dhe politika zhvillimore të guximshme, vendi do të mbetet i varur dhe i varfëruar”, ka thënë Shahini.

BOB REDFORD: SA SHUMË DHIMBJE NË NJË JETË PREJ OSCAR-I

Ai pati gjithçka: talent, bukuri, sukses. Por vuajti shumë. Për nënën e humbur kur ishte djalë i ri, për dy fëmijë të cilët i humbi kur ishte gjallë dhe për dy muaj të tmerrshëm në Firenze që...



Robert Redford vdiq në gjumë, aty ku prehen të drejtët, në moshën 89-vjeçare, por ishte shuar prej kohësh: yje si ai, aq përsosmërisht hollywoodianë e megjithatë i huaj ndaj sistemit, nuk prodhohen më. Ndoshta s'janë prodhuar kurrë; i vetmi përjashtim tjetër është Paul Newman, i cili u përpoq me këmbëngulje që ta merrnin në western-in Butch Cassidy (producenti John Foreman nuk e donte sepse «ende nuk ishte mjaft i famshëm»), duke i hapur dyert e lavdisë.

Bob Redford mori si dhuratë dy gjëra në sasi të madhe: bukuri dhe famë. Dhe urreu dy gjëra me intensitet të madh: bukurinë dhe famën. Megjithëse për karrierën dhe virtytet e tij është thënë gjithçka — aftësia për të mishëruar Amerikën më të mirë, ndonëse në brendësi ndihej «thellësisht european»; aktivizmi mjedisor, përqaftuar përpara se të kthehej në urgjencë apo modë; suksesi si aktor dhe regjisor pa iu dorëzuar Hollywood-it dhe kompromiseve — ka një aspekt që mbeti në hije, ndoshta i ekranizuar nga ajo buzëqeshje dhe ato flokë biondë të dendur, që ishin ftesë për optimizëm: Roberti është një njeri që ka kaluar përmes shumë tragjedi. Duhej të kalonte tre kohë shkatërruese dhe të «kapërcente» një përvojë rinore në Itali, në Firenze, e cila e preku në palcë, duke e ndryshuar rrënjësisht: «Pas atyre muajve nuk kam qenë më i njëjti», tha në intervistat e para.

Plaga e parë është ikja nga kjo botë e nënës së adhuruar, Martha, e cila vdiq nga septicemia në maj 1955, kur Redford ishte 19 vjeç.

«Ishte aq plot gëzim dhe kishte një buzëqeshje aq të ndritshme, sa besoja se ishte e pavdekshme», i tha aktori biografit të tij Michael Feeney Callan. Nuk është thjesht një humbje. Është një humnerë që hapet. Sepse nëna ishte «dritë dhe dije» — ajo ia mësoi ngarjen e makinës (kur Bob ishte 8 vjeç!), vizatimin dhe me të zhytej me të në lojërat me role, që ishte kontakti i parë me aktrimin — ndërsa i ati, Charles, ishte hije dhe censurë. Shumë i pashëm, por belbëzues dhe i pasigurt, Charlie kishte dështuar si muzikant, e pastaj kishte bërë pak karrierë në zyrat e kompanisë së naftës Standard Oil. Me të birin, që ishte rebel dhe kishte të njëjtat prire artistike, ishte i rreptë. «Më kritikonte në çdo fushë, nga sporti te vizatimet; mënyra e tij e komunikimit ishte heshtja», thoshte Bob.

NJË ZBRITJE NË FERR

Për t'i shpëtuar dhimbjes, në pranverën e 1956-s Redford vendosi të linte studimet e artit në University of Colorado dhe të nisej drejt Europës, me dy destinacione në mendje: Parisin dhe Firencen. Donte të studionte piktorët e tij të parapëlqyer — Utrillo, Modigliani, Gauguin — dhe të kuptonte nëse mund të jetonte me vizatimet e tij, kryesisht portrete dhe skica humoristike. Kapitali fillestar ishte i vogël: 600 dollarë. Gjysma shkoi për udhëtimin me klasin e tretë në transatlantikun United States. I ati, Charles, pranoi t'i dërgonte 100 dollarë në muaj, të cilat «megjithatë», siç ka treguar Jack Brendlinger, shoku me të cilin nisi

aventurën europiane, «ai i harxhonte për një javë: pjesën tjetër të kohës jetonte me paratë e mia». Në Paris u regjistrua në École des Beaux-Arts, por gjeti një ambient të ngurtë. Dhe kur policia e rrahu me shkopinj gjatë një proteste kundër shtypjes sovjetike në Hungari, në dhjetor 1956 vendosi të niset drejt Italisë me Jackun.

Në Romë flinte jashtë, në të ftohtë. Sipas një legjende që Redford e ka konfirmuar — «Është e vërtetë. Qesharake, por e vërtetë» — për t'u mbrojtur nga i ftohti dy miqtë mbuloheshin me... pleh stallash (një ide që Bob e kishte marrë nga një rrëfim i Jack Londonit). Në janar 1957 u nda nga Jack dhe shkoi në Firenze.

Me kalimin e viteve i ka kujtuar me mall muajt e tij në Itali, por ai pushim-studim që një zbritje në ferr. «Vendosa të ndahesha nga Brendlinger për një arsye mazokiste: doja të përballesha i vetëm me dhimbjen për humbjen e nënës sime». Në Firenze humb 19 kilogramë për pak javë. E konsumojnë frika e dështimit («Do të më duhej të kthehesha në Los Anxhelos, të jetoja me tim atë») dhe kilometrat që bënte çdo ditë në një rutinë «ushtarake» në antikonformizmin e tij. Ngrihej pas mesditës, hante penne a ravioli, rrëkëllente një kafe në stacion, nisej drejt Ponte Vecchio-s me një bllok fletësh të bardha nën sqetull, që shërbente për gjysmë ditar dhe për gjysmë album vizatimesh: «Në faqet e djathta shënoja mendimet; në të majtat hidhja skicat».

Strehohet te familja Barbieri: «Ata nuk flisnin anglisht, prandaj nuk

kishte komunikim, tamam si me tim atë. Dhe nuk shiheshim kurrë, sepse unë jetoja natën». Edhe këtu problemi kryesor ishte i ftohti. «Pija duhan 20 orë në ditë», i ka rrëfyer Callan-it, «i thyeja më dysh cigaret Alfa dhe i “thithja” derisa më digjinin gishtat: isha i bindur se nëse e mbushja dhomën me tym do të isha ngrohtë».

Kolapsi nervor do të vinte në fund të shkurtit: rrinte për ditë të tëra duke fiksuar sytë te fytyra e vet në pasqyrën sipër lavamanit — donte të çmontonte “si Picasso” tiparet e veta dhe njëkohësisht «të kuptoja kush isha vërtet» — dhe një natë, befas, «nuk e njoha më veten, pata halucinacione, ndjeva një entitet të papërshkrueshëm nën lëkurën time. Nuk kam qenë më i njëjti person pas asaj nate». Fatmirësisht, Tony Reeves, mentori i tij në shkollën e artit, kuptoi vështirësitë e Bob Redfordit dhe organizoi një ekspozitë me vizatimet e tij. Bob mbledhi 200 mijë lireta dhe shkoi me tren në Mynih, ku e priste Brendlinger. Më 14 mars 1957 u kthye në Shtetet e Bashkuara. Pak kohë më pas njohu gruan e parë, Lola Van Wagenen, e cila e shpëtoi nga demonët florentinë. U martua në 1958 dhe u regjistrua në American Academy of Dramatic Arts. Pjesa tjetër është histori, madje legjendë. Edhe pse, përpara trumfeve, erdhi tragjedia më e tmerrshme.

«NJË KATASTROFË KREJT E IMJA»

Lola mbeti shtatzënë pothuaj menjëherë. Më 1 shtator 1959 lindi Scott Anthony Redford.

Roberti do të kujtonte: «Isha euforik nga gëzimi». Dy muaj e gjysmë më pas, më 17 nëntor, i vogli Scott vdiq në gjumë. Reagimi i Bobit, që tashmë luante në Broadway, ishte ai i përhershmi: të lëvizte, të arratiset. Për tre ditë, ai dhe Lola lëvizën pa pushim mes Maryland-it dhe Pensilvanisë. Aktori ka folur rrallë për atë dramë dhe e ka quajtur «një plagë që s'u zhduk kurrë krejt», por i ka pranuar biografit se përveç «një dhimbjeje të vështirë për t'u shprehur me fjalë», ndjeu edhe një ndjenjë faji të pafund: «Kisha hedhur poshtë arsyen e shëndoshë për të ndjekur një jetë të rrezikshme. Im atë më thoshte se isha i papërgjegjshëm. Prindërit e Lolës më thoshin se isha i papërgjegjshëm. Kështu unë ndjeva se vdekja e Scott-it ishte një katastrofë tërësisht e krijuar prej meje». Çifti, që u nda në 1985, pati tre fëmijë të tjerë: Shauna, James dhe Amy.

Nga të tre, James ishte ai që ndoqi më në thellësi hapat e të atit. Të njëjtat tipare, e njëjta buzëqeshje, u bë një regjisor i shkëlqyer dokumentarësh. Vdiq në vitin 2020, pas dy transplantesh të mëlçisë dhe një sëmundjeje të pamëshirshme. Një tjetër goditje për Redfordin. Që e kishte të qartë ç'kishte rëndësi vërtet në jetë. Për revistën People, në fakt, ka thënë: «Po, kam bërë filma interesantë dhe kam marrë kënaqësi në punë, por nëse dikush do të paketonte gjithçka dhe do të më pyeste: “Cili është suksesi yt më i madh?”, s'do të kisha dyshim. Do të përgjigjesha: “Fëmijët e mi. Janë gjëja më e mirë që më ka ndodhur”». / bota.al

PËRMBYSJA E MONGOLËVE: REBELIMI BUDIST QË SHEMBI NJË PERANDORI TË FRIKSHME

Përmbytje, uri, murtajë. Për fshatarët e Kinës Yuan, të sunduar nga pasardhës autoritarë të pushtuesve mongolë që ishin bërë zotër të vendit, kjo seri fatkeqësish natyrore tregonte një gjë: sundimtarët e tyre mongolë e kishin humbur Mandatin e Qiellit. Me Mandatin e Qiellit të hequr, kryengritja nuk ishte thjesht e mundur, por legjitime: vetë Qielli u kërkonte të rrëzonin perandorin e padrejtë dhe ta zëvendësonin me një sundimtar të ri.

Por dinastia Yuan, që rridhte nga Kublai Khani e deri te vetë Genghis Khani, nuk kishte ndërmend të kthehej thjesht mbrapsht në Mongoli. Do të duheshin 17 vjet lufte para se një perandor i ri të mund të themelonte një dinasti të qëndrueshme.

Kushtet për këtë tranzicion të gjatë u hodhën më herët: dobësia politike dhe përçarjet e perandorëve të fundit Yuan, si dhe vargu i fatkeqësive natyrore që goditën Kinën në vitet 1340–1350. Faza e parë e këtyre fatkeqësive e pati kulmin, me përmbytjen e Lumit të Verdhë në vitin 1344. Vetë lumi, që shpesh quhet “Mërzia e Kinës” për shkak të shkatërtimeve që sjell kur vërshon, është pjesë thelbësore e begatisë së vendit, sepse ujërat e tij ujitin sipërfaqe të mëdha bujqësore. Por, siç bart sasi të mëdha dheu, lumi ngre shtratin e vet sa herë rrjedha ngadalësohet, duke shkaktuar aluvione; afërsisht çdo njëqind vjet, Lumi i Verdhë çan përtej digave dhe kërkon një shteg të ri drejt detit. Rrafshhtësia e Fushës së Madhe të Kinës së Veriut – e përsosur për bujqësi – bën që këto shtigje të reja të jenë qindra kilometra larg njëri-tjetrit: në kohë historike, lumi ka derdhur ujërat si në veri, ashtu edhe në jug të Gadishullit Shandong. Përmbytja e vitit 1344 e zhvendosi derdhjen në jug të gadishullit, ku mbeti deri nga mesi i shekullit XIX.

Reagimi i regjimit Yuan ndaj përmbytjes së 1344-s i shkaktoi po aq dëm politik sa vetë fatkeqësia. Për të parandaluar vërshimet e ardhshme, perandori detyroi turma të mëdha fshatarësh Han të ngrinin diga të reja. Por kjo punë e detyruar, në vend që të siguronte regjimin kundër përmbytjeve, thjesht i shtyu edhe më shumë njerëz t’u bashkoheshin grupeve kryengritëse, që po shfaqeshin anembanë Kinës. Nga këto, më e rëndësishmja dhe më e suksesshmja ishte Shoqëria e Lotusit të Bardhë.

Me origjinë si sekt budist, Lotusi i Bardhë iu përshtat përndjekjes nga Yuan-ët duke zgjeruar bazën fetare – duke përfshirë elemente të daoizmit, manikeizmit dhe religionit popullor – dhe bazën shoqërore, duke e hapur anëtarësimin dhe udhëheqjen, edhe për laikët kinezë. Kështu u bë një vatër rezistence ndaj



sundimit të korruptuar të Yuan-ëve.

Lotusi i Bardhë planifikoi të niste një kryengritje të hapur në vitin 1351, por udhëheqësi në pritje, Han Shantong, u tradhëtua dhe u ekzekutua nga Yuan-ët. Megjithatë, Lotusi i Bardhë u bashkua rreth të birit të tij, Han Lin’er, duke e shpallur trashëgimtar legjitim të dinastisë Song që mongolët kishin rrëzuar, me titullin Princi i Vogël të Shkëlqimit. Dokumentet bashkëkohore ose janë humbur, ose janë zhdukur dhe fshehur, ndaj dihet pak për Han Lin’er-in; por është e qartë se një nga gjeneralët e tij, Zhu Yuanzhang, u bë shpejt një figurë kyçe në lëvizjen që mbështeste Princin e Vogël të Shkëlqimit, me aftësitë që peshonin më shumë se origjina e tij modeste.

Ndërkohë që përgjigjja e Yuan-ëve ndaj këtyre kërcënimeve pengohej nga përçarjet dhe rivalitetet politike, e njëjta gjë vlente edhe për rebelët. Gati e vetmja gjë që i bashkonte fillimisht ishin mbulesat e kokës: turbane të kuqe, që i dallonin nga forcat besnike të dinastisë Yuan. Kështu kryengritja mori emrin Kryengritja e Turbaneve të Kuqe.

Si në periudhat e tjera të trazuara të historisë kineze, kryengritja u shndërrua shpejt në garë mes udhëheqësish luftarakë, ku secili kontrollonte një pjesë të madhe të territorit dhe burimeve. Dinastia Yuan, praktikisht, i sabotoi shanset e veta pas vendimit të perandorit Toghon Temür për ta shkarkuar gjeneralin e tij më efektiv, Toqto’a (Toqtoa), dhe pastaj për ta lënë të vrjetë.

Gjenerali Toqto’a, gjithashtu historian i shquar, ishte tepër i dashur mes trupave; po t’i kishte urdhëruar, ato do të ndiqnin flamurin e tij, jo të perandorit. Por Toqto’a e pranoi shkarkimin pa u ngritur kundër tij. Megjithatë, shumë nga ushtarët e tij, të neveritur nga trajtimi i gjeneralit të dashur, dezertuan te forcat e

ndryshme kryengritëse në vend që të luftonin për perandorin.

Vetë Toghon Temür dukej se humbi interesin për luftën, caktoi të birin si trashëgimtar, por bëri pak për të ndalur shpërbërjen e regjimit. Ndërkohë, sundimtarët e Turbaneve të Kuqe po ndërtonin zotërimet e tyre dhe po pozicionoheshin për goditjen përfundimtare kundër Yuan-ëve, duke ruajtur gjithnjë shpinën nga një thikë e mundshme e ndonjë rivali.

Sa më shumë dobësohej pushteti i Yuan-ëve, aq më shumë krerët e Turbaneve të Kuqe e kuptuan se perandori Yuan mund të lihej mënjanë, ndërsa ata vendosnin mes tyre se kush do ta rrëzonte përfundimisht dhe do të bëhej perandor në vend të tij. Në këtë konflikt të çrregullt, me deri në një duzinë pretendentësh, vetëm pak dukej se kishin realisht gjasa ta merrnin pushtetin. Dy kandidatët e parë seriozë ishin Zhang Shicheng (1321–1367) dhe Fang Guozhen (1319–1374), të dy me karriera që kishin nisur me kontrabandë dhe pirateri.

Fang Guozhen ishte pirat; të ardhurat kryesore i vinin nga kontrabanda e kripës (shumë fitimprurëse kur kripa ishte konservuesi i vetëm efektiv dhe shteti e taksonte). Ai dominoi në dete, por nuk arriti të qeveriste me efektivitet brezin bregdetar që kontrollonte.

Ndërsa Zhang Shicheng vuri nën kontroll pjesët më të pasura e më të populluara të Kinës, nga bregdeti në jug të Gadishullit Shandong e në brendësi të fushës pjellore. Sipas historianëve të mëvonshëm, sapo mori nën dorë këto toka të begata, Zhangu dhe rrethi i tij u dhanë pas shfrytëzimit të plaçkës, në vend që të qeverisnin si duhet ose të lëviznin kundër rivalëve. Administrata kineze varej nga një klasë nëpunësish të arsimuar; pa mbështetjen e tyre ishte gati e pamundur të drejtoje një aparat shtetëror efikas.

Për një farë kohe, Chen Youliang (1320–1363) u duk se ishte sundimtari me më shumë gjasa të unifikonte rivalët dhe të rrëzonte Yuan-ët. Duke pritur momentin, ai krijonte aleanca me fraksione të tjera rebelësh, vetëm për t’i tradhtuar më pas. Gjenerali i zotë, por i pamëshirshëm, Chen Youliang ngriti një ushtri të fortë dhe vuri nën kontroll gjithnjë e më shumë territore, derisa në vitin 1360 u ndje aq i fuqishëm sa të shpallej perandor i një ringjalljeje të dinastisë Han (202 p.e.s.–220 e.s.).

Pretendimi i tij i lartë u mbështet thuajse vetëm te forca ushtarake, dhe ambicia e tij u rrëzua në Betejën e Liqenit Poyang (1363). Kjo betejë renditet mes më të mëdheve detare për nga numri i njerëzve të përfshirë: disa vlerësime flasin për deri në 850.000 marinarë, ushtarë e trupa detare.

Beteja vuri përballë përkrahësit e Chen Youliang me njerëzit e Zhu Yuanzhang. Ky i fundit kish bërë rrugë të gjatë, që nga ditët kur ishte shumë i varfër për të paguar edhe aq pak sa i duhej, për të vazhduar të qëndronte në manastirin budist ku kishte kërkuar strehë nga uria. Zhu Yuanzhang mori komandën ushtarake të fraksionit të Turbaneve të Kuqe që kishte dalë nga Shoqëria e Lotusit të Bardhë dhe, pas tradhtisë dhe vrasjes së udhëheqësit të saj të parë, Han Shantong, e zgjeroi gradualisht bazën e tij të pushtetit, duke vazhduar njëherazi të shpallte besnikëri ndaj të birit dhe trashëgimtarit të tij, Han Lin’er. Në 1356, Zhu mori nën kontroll Nanjingun, që u bë kryeqyteti dhe baza e tij e pushtetit. Ndryshe nga sundimtarët e tjerë, Zhu e bëri qeverisjen e mirë një pikë politike: kjo tërhoqi shumë njerëz drejt Nanjingut, të joshur nga stabiliteti, mes dhunës dhe korrupsionit që mbizotëronte në territoret e të tjerëve. Reputacioni i Nanjingut për siguri dhe qeverisje të mirë ishte aq i lartë sa që popullsia e tij u


dhjetëfishua në dekadën pas pushtimit nga Zhu.

Ndërsa Yuan-ët nuk bënëin përpjekje serioze për t’i shpërngulur rebelët, Zhu nisi të ngrinte një administratë që do ta kthente nga sundimtar lokal në perandor, megjithëse publikisht ende shpallte besnikëri ndaj Han Lin’er-it, si perandor i një dinastie Song të ringjallur. Por, duke marrë titullin Duka i Wu-së, Zhu nisi të ngjitej në shkallët e fisnikërisë drejt fronit. Me shumë nga administratorët më të talentuar të vendit që po hynin në shërbimin e tij, Zhu po montonte gradualisht ekipin që do të mund të kontrollonte Kinën.

Së pari, megjithatë, duhej të hiqte qafe rivalin më të rrezikshëm (dhe më të fuqishëm) në lindje, Chen Youliang. Edhe Chen e kuptoi këtë, dhe ai e ndezi betejën vendimtare duke dërguar anijet e tij si kulla të blinduara – mjetet gjigante që mbanin 2.000 trupa, me kuverta të veçanta për kavalerinë dhe një mbisuperstrukturë të blinduar – për të sulmuar kalanë e Zhu-së në Nanchang. Pavarësisht madhësisë së flotës së Chenit, garnizoni i Nanchangut qëndroi dhe dërgoi një lajmëtar te Zhu për ndihmë. Rezultati ishte Beteja e Liqenit Poyang, e cila, gjatë katër ditëve (30 gusht – 2 shtator), i solli Chenit një disfatë taktike, të ndjekur nga shpartallimi më 4 tetor, kur Chen Youliang u vra.

Zhu Yuanzhang-u pastaj iu kthye mbretërisë së Zhang Shichengut, rrethoi kryeqytetin Suzhou dhe e mori në vitin 1367, pas dhjetë muaj rrethimi. Meqë qiejt dukshëm po e favorizonin Zhu-në, sundimtarët e mbetur vendosën se dorëzimi ishte zgjedhja më e mençur dhe u vunë nën sovranitetin e tij. Mbeti, sidoqoftë, çështja e Han Lin’er-it, perandorit të supozuar të një dinastie Song të ringjallur, në shërbim të të cilit Zhu Yuanzhang-u kishte dalë në pah. Pa dyshim, Zhu do të kishte shërbyer nën Han Lin’er-in po të mos kishte ndodhur një aksident fatkeq në 1366 ose 1367, ku Han Lin’er u mbyt në një pellg. Me pretenduesin formal jashtë loje, Zhu Yuanzhang pranoi Mandatin e Qiellit dhe në janar 1368 u shpall perandor, duke marrë emrin Hongwu (“jashtëzakonisht luftarak”). Si perandor, ai themeloi dinastinë Ming, që do të sundonte Kinën deri më 1644.

Pasi hoqi qafe të gjithë rivalët, Perandori Hongwu e ktheu vëmendjen nga shteti i cunuar që Yuan-ët ende mbanin në veriun e Kinës, dhe në 1368 marshoi drejt veriut. Yuan-ët, në vend që të bënin betejë, braktisën kryeqytetin (Pekinin e sotëm) dhe u tërhoqën në Mongoli. Deri në 1381, forcat e perandorit e kishin vënë të gjithë vendin nën kontroll. Pas 89 vitesh sundimi të huaj, kinezët sërish e sundonin Kinën. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Albian Hajdari lë Zvicrën për Kosovën, Ademi i uron mirëseardhje

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Futbollisti i ri i Hoffenheimit, Albian Hajdari, ka hequr dorë përfundimisht nga mundësia për ta përfaqësuar Zvicrën. Ai ka zgjedhur Kombëtaren e Kosovës. Lajmin e ka dhënë presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi. “Kombëtarja e Kosovës ka fituar një zemër të re në fushë dhe një muri të ri në

mbrojtje. Qendërmbrojtësi i talentuar i Hoffenheimit, Albian Hajdari, ka marrë vendimin e madh për t’u bashkuar me fanellën dardane. Albani i bashkuar rrënjëve të tij, duke u kthyer në shtëpinë e tij, Kosovën. Hajdari, i rritur në futbollin zviceran e me një karrierë premtuese në Bundesligë, tani ka zgjedhur që të shkruajë historinë e tij me fanellën dardane. Vendimi i

tij është një mesazh i qartë: Kosova është foleja e ngrohtë dhe zemra gjithmonë rreh më fort për atdheun. Mirë se vjen, Albian! Kosova është më e fortë me ty!”, ka shkruar Ademi në “Facebook”. Mbrojtësi i rritur në Zvicër pritet të jetë në dispozicion të selektorit Franco Foda për dy ndeshjet e tetorit, ndaj Sllovenisë dhe kundër Suedisë në kualifikimet e Botërorit 2026.



AXEL GNAPI, “YLLI I JAVËS” NË SUPERLIGË

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, ka vazhduar ndarjen e çmimit tradicional “Ylli i Javës”, i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e shtatë të këtij edicioni, ky çmim i është dhënë futbollistit të KF Llapit, Axel Gnapi, i cili ka shënuar dy gola, duke e hapur dhe mbyllur serinë e golave në fitoren e parë të skuadrës së tij kundër SC Gjilanit, e cila përfundoi me rezultat 4:1. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të

Futbollit, i përbërë nga: Selajdin Jerliu, Enis Zabërgja dhe Fatmir Mehmeti. Pasi ka marrë këtë çmim, Gnapi është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. “Është një ndjenjë e mirë sepse fillimi i sezonit nuk ishte ashtu siç kemi pritur dhe siç kemi merituar. Pra, kjo fitore e parë është një kënaqësi në momentin e duhur për të gjithë ekipin dhe për stafin, duke shpresuar se kjo është vetëm fillimi i suksesit të Llapit. Pas shumë punës që kemi bërë, tani kemi një atmosferë shumë të mirë në ekip. Çdo lojtar dhe çdo anëtar i ekipit po e mban këtë atmosferë pozitive.

Edhe në humbjet që i kemi pësuar kemi qëndruar bashkë dhe kemi diskutuar për problemet, si dhe çka kemi mundur të bëjmë më mirë që të na vijnë rezultatet. Fillimisht, për skuadrën më duhet të them se kemi cilësi dhe potencial, andaj shpresoj për më të mirën. Do t’i marrim ndeshjet një nga një dhe besoj se do të kemi një sezon shumë të mirë. Ndërsa për çmimin ‘Ylli i Javës’, dua të falënderoj shokët e skuadrës, sepse dje kemi luajtur si një familje. Uroj të fitoj edhe shumë shpërblime të tjera”, ka thënë Gnapi për faqen zyrtare të FFK-së.

GJILANI NDAN RRUGËT ME TRAJNERIN ARDIAN NUHIU

GJILAN, 29 SHTATOR - Ardian Nuhui nuk është më trajner i SC Gjilanit dhe është larguar nga klubi pas një viti e gjysmë. Humbja nga Llapi 4-1 ka qenë vendimtare për të ardhmen e trajnerit, i cili në marrëveshje të dyanshme me klubin ka ndarë rrugët. Ka qenë faqja zyrtare e SC Gjilanit që ka njoftuar për mbylljen e bashkëpunimit me Nuhin, duke i uruar atij suksese në të ardhmen dhe duke e falënderuar për kontributin e dhënë. “Sport Club Gjilani njofton opinionin publik,



tifozët dhe mediat se pas një bashkëpunimi korrekt dhe profesional, në mënyrë të dyanshme është mbyllur bashkëpunimin me kryetrajnerin

Ardian Nuhui. Klubi e falënderon trajnerin Nuhui për punën, përkushtimin dhe kontributin e dhënë gjatë periudhës që ishte pjesë e Sport Club Gjilani. Puna dhe profesionalizmi i tij do të mbeten gjithmonë të vlerësuar nga të gjithë ne. Sport Club Gjilani i uron trajnerit Nuhuit shumë suksese në rrugëtimin e tij të ardhshëm profesional. Klubi do të njoftojë së shpejti opinionin publik për hapat e mëtejshëm në lidhje me stafin teknik dhe drejtimin e skuadrës”, ka njoftuar SC Gjilani.

SIGAL PRISHTINA GATI PËR LIGËN ENBL

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Sigal Prishtina është gati për sezonin e ri në Ligën ENBL, ka paralajmëruar klubi i Superligës së Kosovës në basketboll. Prishtina këtë javë nis rrugëtimin në këtë ligë, në të cilën do të paraqitet për herë të dytë. Ndeshjen e parë Prishtina e luan në kryeqytet kundër ekipit nga Norvegjia, Gimle, që zhvillohet të mërkurën prej orës 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve. Krahas Prishtinës, në këtë sezon në Ligën ENBL do të paraqitet edhe skuadra e Pejës, e cila ndeshjen e parë e luan në palestrën “Karagaqi”



kundër ekipit Riga Zelli më 14 tetor. Sigal Prishtina është pjesë e Grupit 2, kurse Peja do të luajë në Grupin 3, të cilat përbëhen me nga 9 skuadra. Në total, në fazën grupore do të paraqiten 26 skuadra, e 16 prej tyre do të avancojnë më tutje.

Khaka po shihet “trajner i së ardhmes” te Sunderlandi

Sunderland, 29 shtator - Granit Khaka jo vetëm që po e bartë shiritin e kapitenit, por tashmë është shndërruar edhe në lider të skuadrës së Sunderlandit. Pas secilës ndeshje, mesfushori shqiptar po merr lëvdata për paraqitjet e tij në fushë, duke

bërë që Sunderlandi të tubojë 11 pikë pas 6 ndeshjeve në Premierë Ligë. Trajneri i Sunderlandit, Regis Le Bris, ka vazhduar sërish me fjalë të mëdha për Xhakën, këtë herë duke vlerësuar lart leadershipin dhe aftësinë e tij.

“Ne kemi nevojë për një kapiten si Graniti, i cili na jep shumë. Ai e kontrollon ritmin, dhe e kupton lojën si trajner i së ardhmes pasi di si ta menaxhojë në kohë reale”, është shprehur Le Bris. Khaka në afatin kalimtar të

verës u transferua nga Bayer Leverkuseni te Sunderlandi për 15 milionë euro dhe me ekipin anglez ka kontratë deri në vitin 2028. Në gjashtë paraqitje këtë sezon në kampionatin anglez, Khaka ka regjistruar edhe tri asistime.





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Njoftim për vazhdim të afatit të konkursit

KRM "Pastrimi" vazhdon afatin e konkursit publik për pozitën Punëtor i Bartjes në NJO Obiliq, deri më datën 03/10/2025.

KRM "Pastrimi" më datën 11/09/2025 ka hapur konkursin për tri (3) pozita "Punëtor i Bartjes në NJO Obiliq" dhe është mbyllur në datën 25/09/2025.

Obaveštenje o produženju roka konkursa

RPO „Pastrimi“produžava rok javnog konkursa za radno mesto Radnik na sakupljanju otpada u OJ Obilic, do 03.10.2025. godine.

RPO „Pastrimi“ je dana 11.09.2025. godine raspisalo konkurs za tri (3) radna mesta Radnik na sakupljanju otpada u OJ Obilic, koji je bio zatvoren dana 25.09.2025. godine.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Njoftim për vazhdim të afatit të konkursit

KRM "Pastrimi" vazhdon afatin e konkursit publik për pozitën Punëtor i Higjienës Publike në NJO Drenas, deri më datën 03/10/2025.

KRM "Pastrimi" më datën 11/09/2025 ka hapur konkursin për tri (3) pozita "Punëtor i Higjienës Publike në NJO Drenas" dhe është mbyllur në datën 25/09/2025.

Obaveštenje o produženju roka konkursa

RPO "Pastrimi" produžava rok javnog konkursa za radno mesto Radnik na javnoj higijeni u OJ Drenas do datuma 03.10.2025. godine. JKP "Pastrimi" je dana 11.09.2025. godine raspisalo konkurs za tri (3) radna mesta „Radnik na javnoj higijeni u OJ Drenas“, koji je bio zatvoren 25.09.2025. godine.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Haxhi Kabashi shpall të pavlefshme një dëftesë të QK "11 Marsi", Prizren.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

- Rinor Berisha shpall të pavlefshme 3 dëftesat e QK "11 Marsi", Prizren.

- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Luciano Motroni" Prizren.

- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK "11 Marsi", Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë "Htsni Zajmi".

- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë "Lush Marku" Brekoc, Gjakovë.

- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. "Gjon Nikolle Kazazi" Teknologji Informative Gjakove.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Luigj Gurakuqi" Nashec.

- NNSH "Meridian", shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K "11 Marsi" Prizren.

- "Vr Digital Agency" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- "Reisa 2022" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- "Fire Protection Agency Rifiel Action" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.



NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë

Ndërmarrja SWISS SOLAR PARK L.L.C. me adresë Rr. Mbretëresha Tetuta, PN, Gjakovë, Republika e Kosovës, në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj NJOFTON palët e interesit se ka aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Aplikacioni për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimarrje.

Licencimi i furnizimit me energji elektrike, i ndërmarrjes SWISS SOLAR PARK L.L.C. përveç tjerash do të përmbajë:

- Territori i mbuluar nga Licenca është Republika e Kosovës.
- I licencuari ka të drejtë të blej, shes, ri-shes, importoj dhe eksportoj energji elektrike.
- I licencuari ka të drejtë të shes energji konsumatorëve fundor, të faturoj dhe inkasoj të hyra për energjinë e shitur, si dhe të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve.

I licencuari mund të kryej aktivitetin e furnizimit me energji elektrike në pajtim me dispozitat e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë. Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. Bekim Fehiu (ish Ndërtesa e Fazitës) Kati II, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hrexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118/045787077.

SWISS SOLAR PARK L.L.C.
Rr. Mbretëresha Tetuta, PN, Gjakovë, Republika e Kosovës

Thirrje për Aplikim

Kompania: Samire Millaku Jusufi B.I

NUI: 811467639

Adresa: Skender Rexhepi, p.n-Klinë

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

Ngritja e serrës së re: me sipërfaqe prej 4000 m², me infrastrukturë përcjellëse

Investimi pëfshinë: *Ndertimin e serrës se re me sipërfaqe prej 4000 m², me profile të zingurara komplet, duke përfshir edhe Hapjen e serres ansore automatike me panel elektronik me 2 sete.*

Investimi do të bëhet në adresën: Skender Rexhepi, p.n-Klinë

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë nëpërmjet email:

samiremillaku@gmail.com apo telefonit 049-883-645 dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes/publikimit. Ndërsa, afati kohor për të dorëzimin e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, nga data e dergimit të fteses per koutim tek të gjithë ofertuesit/kompanit e interesuara.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:

+383-049-883-645



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

